



REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
Nr. i flet. 03
Broj stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 06-d/1157/22
Prot. No.
Data 11-03-2022

PUSHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7, paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 11.03.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-DPKI-06-2804/21, për zyrtarin e lartë publik z. Qendrim Vitija, Kryesues i Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kuzhina Qendrore” Sh.A., përkatësisht Zyrtar përgjegjës i Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Lokale “Trafiku Urban”, për shkak se është shmangur gjendja papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m i

I. Pas pranimit të informacionit të jashtëm nën dyshimin për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia kundër Korrupsionit ka hapur rastin me numër protokollit AKK-DPKI-06-2804/21, për zyrtarin e lartë z. Qendrim Vitija, Zyrtar përgjegjës i Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Lokale “Trafiku Urban” (në vijim: Zyrtar përgjegjës i Prokurimit në NPL “Trafiku Urban”), duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni duke mbledhur dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet përkatëse, prej nga rezultoi se z. Qendrim Vitija, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Zyrtar përgjegjës i Prokurimit në NPL “Trafiku Urban”, ushtron edhe funksionin e Kryesuesit të Bordit

të Ndërmarrjen Publike Lokale “Kuzhina Qendrore” Sh.A., (në vijim: Kryesues i Bordit në NPL “Kuzhina Qendrore”).

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-2804/21, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Qendrim Vitija për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, me ç’rast është organizuar dhe mbajtur një takim me palën brenda Agjencisë kundër Korrupsionit.

Në takim, palës i është sqaruar se në parim, me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, zyrtarit të lartë publik, në rastin konkret Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit në NPL “Trafiku Urban”, nuk i ndalohej që të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin e anëtarit (kryesuesit) të Bordit në NPL “Kuzhina Qendrore”, por megjithatë dispozitat e Ligjit në fjalë kanë paraparë disa kufizime për situata të tilla, konkretisht dispozita e nenit 13, paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”.

Pra, me këtë rast palës i është bërë me dije se me rastin e emërimit të tij në pozitën e anëtarit (kryesuesit) të Bordit në NPL “Kuzhina Qendrore”, vlen kufizimi i dispozitës së sipërcituar, konkretisht pjesës së dytë të paragrafit në fjalë, ku përcaktohet se *“Zyrtari i lartë [...] nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, me qëllim të zbatimit të kësaj dispozite, zyrtari i lartë z. Vitija ka ndërmarr veprime të menjëhershme dhe është shprehur i gatshëm t’i zbatoj të gjitha vendimet që do t’i nxjerrin organet përkatëse të Ndërmarrjes NPL “Kuzhina Qendrore”, në drejtim të zbatimit të kësaj dispozite në rastin konkret.

Më pas, duke vepruar sipas kërkesës së dispozitës së sipërcituar të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe sqarimeve plotësuese të paraqitura nga Agjencia kundër Korrupsionit, Komisioni i Auditimit të Brendshëm i NPL “Kuzhina Qendrore”, në bazë të nenit 20.4 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, e në pajtim me nenet 20.1, 20.2, 20.3, 20.5 dhe nenin 22 të këtij Ligji, ka aprovuar *“Deklaratën për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve të NP Kuzhina Qendrore” (Nr.0102/2, Dt.10.03.2022)*, me ç’rast janë krijuar rrethana të reja përkitazi me kufizimin sa i përket shpërblimit me pagesë, me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.




Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit